REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 726/20
Datë/Datum. 09.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	02.10.2020	09.10.2020

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.09.2020, OE "Miri", ka parashtruar ankesë me nr: 726/20, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, me titull: "Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve tip Toyota" (Lot 1), me nr. të prokurimit: 20-3497-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Oper. Sistemi,Trans dhe Tregu - KOSTT Sh.a..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 40,000.00€.
Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 09.07.2020, data e hapjes së ofertës: 05.08.2020, data e vendimit për dhënien e kontratës: 14.09.2020, data e njoftimit të me letër standarde: 14.09.2020.
Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues, ne ankesen e tij pretendon se autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundershtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59 dhe 61 te LPP-se. njeherit pretendon se me rastin e vleresimit te ofertave dhe pergjigjes se dhene nga OE ankues, autoriteti kontaktues ka pranuar shpjegime te arsyeshme lidhur me cmimet e dhena ne oferten e tij.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

N/A

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Te gjithe operatoret ekonomik pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit jane te papërgjegjshëm.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesen e tij pretendon se AK-ja, kryesisht nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 61 te LPP-se, per me arsyetimin se kemi dhene sqarime te detajuara te cmimeve ne pozicionet e kerkuara nga AK-ja.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eshte njoftuar nga AK-ja, me letren standarde te tenderuesit te eliminuar me arsyetimin se: Edhe pse pas kërkesës për sqarime të çmimeve jo normalisht të ulëta, Ju si OE nuk keni arritur të na bindeni neve si AK KOSTT, prandaj konform Nenit 61.1 dhe 61.4 të LPP-së dhe oferta e Juaj refuzohet si Jo-normalisht e ulët.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, gjate vleresimit te ofertave ka verejtur se OE ankues ka ofruar cmime Jo/Normalishte te uleta dhe njeherit ka kekruar sqarim te pozicioneve nga OE ankues.
Konform kerkeses se AK-se, me daten: 09.09.2020 OE ankues ka kthyer pergjigje i cili i ka shpjeguar autoritetit kontraktues pozicionet per te cilat autoriteti kontraktues ka pasur dyshime.

Pas pranimit te pergjigjes autoriteti kontraktues Operator Sistemi,Trans dhe Tregu, ne perputhje me paragrafin 4 te nenit 61 te LPP-se e ka eliminuar duke i konsideruar se arsyetimi i OE ankues nuk ka qene bindes per autoritetin kontraktues.

Eksperti shqyrtues, vlereson se vleresimi i cmimeve sipas dispozitave te nenit 61 te LPP-se eshte ne te drejten e autoritetit kontraktues, prandaj eksperti shqyrtues, vlereson pretendimi i OE ankues lidhur me mos respektimin e procedurave te parapara sipa snenit 61 te LPP-se, nuk qendron edhe per faktin se autoriteti kontraktues, i ka zbatuar procedurat Inter partes.

Poashtu sa i perket pretendimit dhe arsyetimit te OE ankues se ka pasur pozitcione te nderrimit te pjeseve te cilat nuk u perkasin automjeteve te precizuara ne dosje. Eksperti shqyrtues sqaron se eshte dashur te reagoje me shkrim apo edhe permes kerkeses per rishqyrtim ne fazen e kritereve me qellim te permiresimit te atyre pozicioneve, sic parashihet ne nenin 108/A, pika 3.1 ku thuhet: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me **njoftimin e kontratës** ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

Prandaj, eksperti shqyrtues, vlerson se edhe ky pretendim eshte i paqendrueshem.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te refuzohet si e pabazuar, ndersa vendimi i AK-së për anulim te aktivitetit te prokurimit te mbetet ne fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOSTT.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - MIRI.